



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, më 5 qershor 2025, Trupi Gjykses lëshoi urdhrin mbi orarin e ndryshuar në lidhje me hapat e ardhshëm në këtë çështje gjyqësore.

Gjykatësit urdhëruan Mbrojtjen që të parashtrojë kërkesën e përbashkët për rrëzimin e akuzave sipas rregullës 130, deri më 12 qershor. Pas kësaj, Zyra e Prokurorit të Specializuar ka afat deri më 7 korrik për t'u përgjigjur. Trupi Gjykses bëri të ditur gjithashtu se planifikon të vendosë mbi kërkesën e përbashkët të Mbrojtjes për rrëzimin e akuzave në javën e 14 korrikut.

Në qoftë se Trupi Gjykses hedh poshtë kërkesën e Mbrojtjes në tërësi ose pjesërisht, Mbrojtësi i Viktimave urdhërohet që të jetë gati të fillojë të thërrasë dëshmitarët më 16 korrik. Gjithashtu edhe ekipet e Mbrojtjes duhet të njoftojnë Trupin Gjykses më 16 korrik nëse planifikojnë të paraqesin prova dhe të thërrasin dëshmitarë.

Më shumë hollësi mund të gjeni në urdhrin e Trupit Gjykses në lidhje me orarin e ndryshuar në faqen e internetit të DHSK-së.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, Mbrojtësi i Viktimave informoi Gjykatën se një prej viktimave pjesëmarrëse ka ndërruar jetë. Viktima ishte pranuar për të marrë pjesë në proces si pasojë e dëmit mendor të pësuar si viktimitë e tërthortë e arrestimit arbitrar, ndalimit, trajtimit çnjerëzor, vrasjes së paligjshme dhe zhdukjes me forcë.

Më 4 qershor 2025, Trupi Gjykses pranoi një viktimitë shtesë për pjesëmarrje në proces. Viktima pjesëmarrëse do të përfshihet në grupin ekzistues të viktimave, që përfaqësohet nga i njëjti Mbrojtës i Viktimave. Trupi Gjykses theksoi në vendim se afati për parashtrimin e kërkesave për pjesëmarrje në proces nga viktimat në këtë çështje gjyqësore kishte përfunduar më 15 shkurt 2023. Megjithatë, pasi konstatoi ekzistencën e arsyeve të vlefshme, Trupi Gjykses pranoi kërkesën.

Më 5 qershor 2025, Trupi Gjykses hodhi poshtë kërkesën e Mbrojtjes së Veselit për apelim të një vendimi të mëhershëm të Trupit Gjykses për të pranuar si prova dokumentet nga zona e Dukagjinit. Trupi Gjykses theksoi se kishte vlerësuar me kujdes secilin prej dokumenteve në fjalë.

Më 11 qershor u lëshuan versionet publike të vendimeve mbi kërkesat për lirim të përkohshëm të Jakup Krasniqit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit. Trupi Gjykses hodhi poshtë kërkesat në vendime më vete, duke konstatuar se vazhdon të ekzistojë rreziku se të akuzuarit mund të pengojnë ecurinë e procesit dhe/ose të





kryejnë vepra penale të mëtejshme, duke pasur parasysh se Mbrojtësi i Viktimave do të dorëzojë listën e dëshmitarëve të mundshëm për argumentet e veta dhe, rrjedhimisht, të akuzuarit do të kenë informacion të ndjeshëm. Sipas mendimit të Trupit Gjykues, arsyet që mori parasysh në lidhje me dëshmitarët e ZPS-së vlejnë njëloj edhe për dëshmitarët që do të thirren nga Mbrojtësi i Viktimave. Trupi Gjykues më tej theksoi se rreziku i ndërhyrjes mund të ekzistojë edhe në lidhje me dëshmitarë që mund të thërrasë Mbrojtja dhe se dëshmitarët që tashmë kanë dhënë dëshmi në këtë çështje gjyqësore si dhe dëshmitarë të tjerë relevantë për procesin mund të jenë objekt i ndërhyrjes ose hakmarrjes.

Në çështjen gjyqësore të Hashim Thaçit, Isni Kilajt, Bashkim Smakajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake lëshoi një numër vendimesh në lidhje me paraburgimin gjatë javës që kaloi. Sipas Ligjit për DHSK-në, një person mund të mbahet në paraburgim në pritje të gjykimin vetëm në rrethana të caktuara, përfshirë në qoftë se ekziston rreziku që t'i ikë drejtësisë ose të ndërhyjë ndaj dëshmitarëve.

Rikujtojmë se kjo çështje gjyqësore është tjetër nga gjykimi në të cilin z. Thaçi dhe tre të tjerë akuzohen për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Kjo çështje gjyqësore, që është ende në fazën e procedurës paraprake, ka të bëjë me akuzat e Prokurorisë se z. Thaçi dhe të tjerë në mënyrë të paligjshme ndikuan në dëshmitë e dëshmitarëve në gjykimin e z. Thaçi për krime lufte.

Më 5 qershor, në vendime më vete, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstatoi se ka arsye të artikulueshme për të besuar se Hashim Thaçi, Isni Kilaj, Bashkim Smakaj, dhe Fadil Fazliu mund të arratisen, të pengojnë ecurinë e procesit, ose të kryejnë vepra penale të mëtejshme, dhe se këto rreziqe nuk mund të zvogëlohen mjaftueshëm me asnjë nga kushtet e propozuara ose kushte të tjera shtesë për lirim.

Gjatë shqyrtimit të rrezikut se z. Thaçi mund të pengojë procesin, Gjykatësja iu referua pretendimeve se z. Thaçi bashkërendoi tre grupe të ndryshme, të cilat i udhëhoqi ai vetë, për të ndërhyrë ndaj dëshmitarëve të Prokurorisë në gjykimin aktual të z. Thaçi për krime lufte, dhe se u dha udhëzime të tjerëve që të ndiknin në mënyrë të paligjshme në dëshmitë e dëshmitarëve. Ajo gjykoi gjithashtu se veprimet e z. Thaçi tregojnë këmbëngulje për të vijuar përpjekjet për pengimin e procesit nga objekti i paraburgimit, përfshirë përmes ushtrimit të ndikimit mbi bashkëpunëtorët e tij të mëhershëm në UÇK të cilët janë besnikë ndaj tij, dhe mbi njerëz nga qarqet politike të tij. Gjykatësja iu referua edhe konstatimeve të mëparshme që sugjerojnë se në të kaluarën, z. Thaçi u orvat të dëmtonte Dhomat e Specializuara, dhe përmes qarqeve të tij u ofroi shpërblime personave që u thirrën nga ZPS-ja për t'i dhënë informacion ZPS-së dhe Dhomave të Specializuara.

Gjykatësja e Procedurës Paraprake theksoi se Prokuroria ka përfunduar me paraqitjen e provave në gjykimin *Thaçi dhe të tjerët* për krime lufte, por gjykoi se rreziku i pengimit të dëshmitarë dhe viktimave vazhdon të ekzistojë, meqenëse: (i) gjykimi i z. Thaçi për krime lufte ende nuk ka përfunduar dhe Trupi Gjykues mund të dëgjojë dëshmi të tjera nga viktimat pjesëmarrëse, dëshmitarë të mbrojtjes si dhe kundërprova, përfshirë nga





dëshmitarë që tashmë mund të kenë dhënë dëshmi; dhe (ii) Trup Gjykues mund, në rrethana të jashtëzakonshme, të dëgjojë prova shtesë pas mbylljes së paraqitjes së provave sipas rregullës 136 të Rregullores.

Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjithashtu konstatoi se ekziston rreziku që z. Thaçi të pengojë zhvillimin e procesit të drejtësisë në çështjen tjetër ndaj tij në lidhje me ndërhyrje të pretenduar ndaj dëshmitarëve.

